



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 17203 prot.

Lezhë, më: 02.10. .2025

PROJEKT-V E N D I M

NR. _____, Datë 02.10., 2025

PËR
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA
FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI TË
BASHKISË, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR NË OBJEKTIN
GJOBARDHAJ, NGA SHOQËRIA "GJONI" SHPK

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **6.775 ha** pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur.
2. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor kombëtar detajohet si mëposhtë:
 - **3.83 ha** pyll në ngastrën pyjore **103**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".
 - **2.85 ha** pyll në ngastrën pyjore **17**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".
 - **0.095 ha** pyll në ngastrën pyjore **18a**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".

3. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku kryhet aktiviteti, bëhet nga shoqëria "GJONI"sh.p.k, sipas marrëveshjes së dakortësuar me Bashkinë, pasi të miratohet heqja nga fondi pyjor.
4. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 17203/prot.

Lezhë, më: 02.10.2025

RELACION
PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË HEQJES NGA FONDI PYJOR
KOMBËTAR PËR SIPËRFAQET PYJORE BASHKIAKE QË DO TË PREKEN NGA
AKTIVITETI I LEJES MINERARE NË OBJEKTIN GJOBARDHAJ, NGA
SHOQËRIA "GJONI" SHPK

Shoqëria "GJONI"sh.p.k ka paraqitur kërkesën online me datë 15.09.2025 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për heqje nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes që në zbatim të Lejes numër 1488/2, datë 13.10.2022 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të zhvillohet aktiviteti minerar në objektin **GJOBARDHAJ**, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes **6.775 ha** pyll që do të shërbejë për kryerjen e aktivitetit minerar.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet shkresës numër 6773 protokoll datë 19.09.2025 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga leja e aktivitetit minerar, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga zhvillimi i aktivitetit minerar.

Sipërfaqet pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", të ndryshuar dhe bëjnë pjesë në ngastrat pyjore **103, 17 e 18a** të Ekonomisë Pyjore "Brinjat e Kreshhtës".

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **6.775 ha** pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

Hartoi relacionin
Ing. Artan PALUSHI



DREJTORI
Paulin GJERGJI



KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 17203/2 Prot.

Lezhë më 02 / 10 / 2025

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Pjerin NDREU



RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË.**

*Lloji i aktivitetit: Leje minerare shfrytëzimi për mineralin gur dekorativ(Gabro), nga
Kompania "GJONI" sh.p.k*

Bazuar në kërkesën me numër 6773 protokoll datë 19.09.2025 të paraqitur nga Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për përgatitje të raportit tekniko ekonomik për heqje nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqeve pyjore Bashkiake që preken nga Leja numër 1488/2, datë 13.10.2022 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, grupi i punës i përbërë nga **Inxh. Ardit Molla dhe Inxh. Blerim Rrema**, hartoi raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore që preken nga zbatimi i kësaj lejeje.

Duke filluar nga data 01.10.2025 deri në datën 02.10.2025, grupi i punës mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe realizoi verifikimin në terren e në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore, objekt për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes së kërkuar.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor rezulton se sipërfaqja e kërkuar që hiqet nga fondi pyjor kombëtar është **6.775 ha** dhe shtrihet në pasuritë si mëposhtë:

Nr	Ek Pyjore	Ngastra
1	Brinjat e Kreshtës	103
2	Brinjat e Kreshtës	17
3	Brinjat e Kreshtës	18a

Këto sipërfaqe pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqeve në objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat që i bashkangjiten këtij raporti teknik. Nga verifikimi në terren rezultojnë të dhënat e pasqyruara në tabelat bashkangjitur raportit teknik.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “**GJONP**” sh.p.k e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesorë të grumbujve në pasuritë pyjore si mëposhtë e cila është në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Nr.	Nr.	Ekonomia	Forma e Qeverisjes	Përbërja e grumbullit
Rendor	Ngastre	Pyjore		Pyjor
1	103	Brinjat e Kreshtës	Trungishte	Pishë mesdhetare
2	17	Brinjat e Kreshtës	Shkurre	Shqeme+shkurre te tjera
3	18a	Brinjat e Kreshtës	Cungishte	Dushqe

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e kërkuar, vetëm pas miratimit të heqjes nga fondi pyjor kombëtar dhe pasi ka kryer pagesën e vlerës së materialit drusor prej **30740.5 Lekë**.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

a. Vlerën e sipërfaqes së dhënë në përdorim lekë/ha/vit

b. Vlerën e përdorimit të rrugës lekë/km/vit

c. Vlera e lëndës drusore që do pritët, (sipas tabelës 4)

1. Lëndë punimi(cungishte) 0.22×3200 lekë = 704 lekë

2. Dru zjarri(cungishte) 0.75×600 lekë = 450 lekë

3. Dru zjarri(trungishte) $62.81 \text{ m}^3 \times 250$ lekë = 15702.5 lekë

4. Dru zjarri(shkurre) $23.14 \text{ m}^3 \times 600$ lekë = 13884 lekë

Totali (a+b+c) = 30740.5 Lekë

Kompania do të kryejë rehabilitimin mjedisor sipas aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përlogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor" të përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Në këtë raport janë bërë vlerësimet e sipërfaqeve pyjore në të cilat do të hiqen nga fondi pyjor kombëtar si rezultat i zhvillimit të aktivitetit të lejes minerare të shfrytëzimit për mineralin gur dekorativ(Gabro), nga Kompania "GJONI" sh.p.k.

Bashkangjitur raportit, hartat, tabelat vlerësuese dhe dokumentacioni i paraqitur nga kompania.

HARTUAN RAPORTIN

Inxh. Ardit Molla




Inxh. Blerim Rrema



KONTROLLUAN RAPORTIN


PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi



DREJTORI

Paulin Gjergji



Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)
(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro)

Tabela 1

ID. Prones	Ekon.Pyjore	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore		
						Mosha	K.D	D mes mes	Lart. mes	Filizeria pylli	Nen	Katet per ha m3	Total m3
LE08 00 103	Brinjat e kreshtes	103	Pishe	Prodhues	Trungishte	47	0.6				N	16.4	687.65
LE08 00 017	Brinjat e kreshtes	17	Te perzier	Prodhues	Shkurre	52	0.6				N	0	0
LE08 00 018a	Brinjat e kreshtes	18a	Qarr+Bunge	Prodhues	Cungishte	72	0.4				N	10.25	349.83

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren)
(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro)

ID. Prones	Ekon.Pyjore	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore	
						Mosha	K.D	D mes mes	Lart. Filizeria	Nen pylli	Katet per ha m3	Total m3
LE08 00 103	Brinjat e kreshtes	103	Pishe	Prodhues	Trungishte	47	0.6			N	16.4	687.65
LE08 00 017	Brinjat e kreshtes	17	Te perzier	Prodhues	Shkurre	52	0.6			N	8.12	248.63
LE08 00 018a	Brinjat e kreshtes	18a	Qarr+Bunge	Prodhues	Cungishte	72	0.4			N	10.25	349.83

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

TABELË E PËRSHKRIMIT TË SIPËRFAQES KULLLORE

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro)

[illegible]

PLOTËSËI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

Investime te kryera ne vite

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro) Tabela 3

ID Prone	Perdorimi	Ekon.pyj/ kulllos	Parc	Sip total ha	Sip me punime	Viti I kryerjes punimeve	Punimi I kryer ne ha/m3		Vlera investimit 000/leke
							pyllezim	permiresh	
LE08 00 103	Trungishte	Brinjat e kreshtes	103	41.93					
LE08 00 017	Shkurre	Brinjat e kreshtes	17	30.62					
LE08 00 018a	Cungishte	Brinjat e kreshtes	18a	34.13					

Kjo tabele plotësohet nese ka pasur investime te realizuar ne vite

PLOTËSOI: Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELA PERMBLEDHESHE E VLERESIMIT FINANCIAR

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro)

Tabela 4

Perdorimi i territorit	Sip.Ha qe hiqet	Asortimenti	Volumi m3 sipas asortimenteve	Vlera			Siperfaqja ne perdorim			Vlera e siperfaqes ne perdorim			Gjatesia e perdorimit km rruge	Tarifa dhenie ne perdorim lek/km/vit		TOTALI
				lek/m3	Shuma I	Shuma II	lek/ha per 2 vjet	Shuma II	lek/ha per 2 vjet	Shuma II	per 2 vjet	Shuma III				
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11					
Trungishte pi	3.83	dru zjarri	62.81	250	15703	0	0	0	0	0	0	0	0	15702.5		
Trungishte Pi		lpm+t	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Cungishte	0.095	dru zjarri	0.75	600	450	0	0	0	0	0	0	0	0	450	0	0
Cungishte	0.095	lpm+t	0.22	3200	704	0	0	0	0	0	0	0	0	704	0	0
Shkurre	2.85	dru zjarri	23.14	600	13884	0	0	0	0	0	0	0	0	13884	0	0
Kullote	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
B.pyjore+Djerr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inproduktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bime mjek/med	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjuetia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest realizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithesejt	6.870	0	86.92		30740.5	0	0	0	0	0	0	0	0	30740.5	0	0

PLOTESOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

LISTA E PRONAVE TË FONDIT PYJOR BASHKIAK QË HIQEN

NGA FONDI PYJOR

KOMBËTAR

Tabela 5

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur dekorativ Gabro)

Nr. ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosores	Ng/n/gast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/kullosores ha	Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosores ha	Gjatesia ne perdorim km		
					Rruge	Linje	Tubacion/kanal
1	2	3	4	5	6	7	8
1 LE08 00 103	Brinjat e kreshtes	103	3.83	0	0	0	0
2 LE08 00 017	Brinjat e kreshtes	17	2.85	0	0	0	0
3 LE08 00 018a	Brinjat e kreshtes	18a	0.095				
			6.775	0	0	0	0

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

PËRGJEGJËSI



Inxh. Artan Palushi

Shenim:

Ne rastin e Hec-eve,rrugeve apo linjave gjatesore, plotesohet e gjithe tabela.. Kollona 6 llogaritet ne siperfaqe per efekt te llogaritjes se volumeve qe hiqen dhe kollonat 7-9 per tarifen e perdorimit ne km /lek/ vite

Ne rastet e heqjes nga fondi pyjor per ndertime, miniera rruge etj plotesohet tabela deri ne kollonen 5

PLANIMETRIA E ZONES



PLANVENDOSJA MBI HARTEN TOPOGRAFIKE , SH. 1:10000



PLANVENDOSJA MBI HARTEN PYORE , SH. 1:10000

IDENTIFIKIMI I PARCELES

ZONA KADASTRALE : 1783
 SUPERRAJA E ZONES : 74575 m² (7.4 ha)
 ADRESA: GJONDAUDHAJ, UNGREJ, BASHKIA LEZHË
 NGASTRA PYORE E PËRKUR :
 LE 80 00 (103) - Superfaqe = 38263 m² (3.83 ha)
 LE 80 00 (017) - Superfaqe = 28535 m² (2.85 ha)
 LE 80 00 (018a) - Superfaqe = 950 m² (0.095 ha)
 Superfaqja totale që do hiet nga fondi pyor : 42748 m² (4.275 ha)

LEGJENDA

- KURRI I SUPERRAJES
- DE DO HIEJ NGA FONDI PYOR
- NGASTRA PYORE LE 80 00 (103)
- NGASTRA PYORE LE 80 00 (017)
- NGASTRA PYORE LE 80 00 (018a)
- NGASTRA PYORE KURRI

SPECIFIKIME TEKNIKE

- SISTEMI KOORDINATIV : KRGISI
- LARTESIA : ABSOLUTE
- HARTA PYORE
- HARTË TOPOGRAFIKE (K-34-76-B-a-3)
- ORTOFOTO 2015

Pika	X	Y
1	482567.76	464333.93
2	482525.69	464350.74
3	482685.97	464350.617
4	482685.157	464352.604
5	482646.0754	4643498.682
6	483043.594	464356.46
7	483043.594	4643472.786
8	482607.232	4643322.76
9	482616.597	4643456.811
10	482458.619	4643279.979

AUTOR

ING. LUCIANO KASNECI

POROSITËS

"GJONI" SH.P.K



VULA

Luciano
 Kasneci
 18.11.01.02007



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

Nr. 6773 prot.

Tiranë, më 19.9.2025

Lënda: Mbi përgatitjen e raportit teknik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të këshillit bashkiak



BASHKISË LEZHË

Për dijeni:

SHOQËRISË "GJONI" sh.p.k.

*Lagja "Qendër", Rruga e Përroit, Karrierë guri dekorativ
Në Zonën Kadastrale nr. 1747, nr. pasurie 177/1-1, Ungrej, LEZHË*

Në vijim të kërkesës së shoqërisë "Gjoni" sh.p.k. ardhur *on line* datë 15.09.2025, dhe pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, lidhur me procedurën e heqjes nga fondi pyjor publik për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin "Gjonbardhaj", Bashkia Lezhë, bazuar në lejen minerare nr. 1488/2, datë 13.10.2022, dhënë nga MIE si dhe Leje Mjedisi të tipit B me nr. identifikimi 3725/1, datë 23.06.2022, ju informojmë se:

Referuar ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet"; VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kapitulli II, pika 5 dhe 6; VKM-së nr. 684, datë 2.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433, datë 8.06.2016 "Për transferimin sipas listave të inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive, në pronësi të bashkive", të ndryshuar, nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, kërkohet përgatitja e raportit tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore publike objekt shfrytëzimi, që hiqet nga fondi pyjor publik sipas dokumentacionit të aplikimit.

Një kopje e dokumentacionit të përgatitur dërgohet pranë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit për vijimin më tej të procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe pakësimin në volum.

Dërgimi i raportit tekniko-ekonomik duhet të shoqërohet dhe me dakortësinë me vendim të Këshillit të Bashkisë, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III, të V.K.M. nr. 888, datë 27.12.2022, i cili duhet të përmbajë të dhënat kadastrale për sipërfaqen që hiqet.


Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin ligjor dhe teknik të depozituar nga shoqëria.

Lutemi kryerjen e procedurave të cituara më lart, **brenda afateve ligjore** të përcaktuara në VKM nr.888/2022, kapitulli II, pika 6.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 6516/prot.
2

Tiranë, më 13.10.2022

Lënda: Akt - Miratimi mbi kërkesën me numër çështje, LC - 4379-06 - 2022.

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Blv: "Zhan D'Ark", Pranë Ministrisë së Jashtme, Tiranë.

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

"Blloku Vasil Shanto", NR.18, Tiranë.

SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Rruga: "Myslym Keta", Tiranë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Akt - Miratimin Nr.1488/2, për ndryshimin e koordinatave (zgjerim sipërfaqe) të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1488/1, datë 02.08.2010, (shtyrë afati 10 vjeçar i vlefshmërisë me Akt - miratimin Nr.1488/1, datë 12.07.2021), për leje minerare shfrytëzimi të subjektit "GJONI" sh.p.k, për kërkesën në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër çështje LC-4379-06-2022, datë 30.06.2022, për mineralin gabro, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, në objektin "Gjonbardhaj", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Ky Akt - Miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN, opionencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, nr.28/2022, dt 30.08.2022, "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit, programit të investimeve për shfrytëzimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare", të dokumentacionit me numër aplikimi në QKB, nr.LC-4379-06-2022, të subjektit "GJONI" Sh.p.k, për mineralin gabro në objektin "Gjonbardhaj", Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022).

Faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTRI

Bëinda Balluku

Me Autorizim
ZEVENDËSMINISTRI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

MINISTRI

Nr. 6516/prot.
13

Tiranë, më 13.10.2022

Lënda: Njoftim për Garancitë Financiare.

SHOQËRISË "GJONI" SH.P.K

Lezhë, Ungrej, Lagjia Qender, Rruga e Përroit, Kariere gur dekorativ në zonën kadastrale
nr.1747, nr.Pasurie 177/1 - 1.

Për-dijeni: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Blv: "Zhan D'Arle", Pranë Ministrisë së Jashtme, Tiranë.

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

"Biloku Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë.

SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

Rruga: "Myslym Keta", Tiranë.

Ju njoftojmë se, në Akt - Miratimin Nr. 1488/2, për pajisje me Leje Minerare Shfrytëzimi, për ndryshimin e koordinatave (zgjerim sipërfaqe) të Lejes Minerare të Shfrytëzimit nr.1488/1, dt 02.08.2010, (shpreh afati 10 vjeçar i vlefshmërisë me Akt - miratimin Nr.1488/1, datë 12.07.2021) për mineralin gëbro, të subjektit "GJONI" Sh.p.k, për kërkesën në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër çështje LC- 4379 -06-2022 dt 30.06.2022, në objektin "Gjonbardhaj", Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, është përcaktuar se:

"Përfituesi i shprehjes së afatit të lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislativës mjedisore apo legjislativës të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineralit për të cilët i është dhënë kjo leje".

Konkretisht, në Akt - Miratimin Nr.1488/2 citohet se:

T: Vlera e garancisë financiare për për realizimin e planit të investimit maksimal, për vitin me investimet më të larta, e miratuar me VKT të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot.MIE dt 01.09.2022) është 50.000 lekë.

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë. Faqja web: <http://www.infrastruktura.gov.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 6516/ Prof.

Tiranë, më 13/10/2022

AKT - MIRATIMI NR. 1488/2

Për Aplikimin në Qendër Kombëtare të Bisnesit (QKB) me numër çështje LC - 4379 - 06 - 2022, datë 30.06.2022, për ndryshimin e koordinatave (zgjerim sipërfaqe) të lejes minerare të shfrytëzimit, Nr. 1488/1, datë 02.08.2010, (shtyrë afati 10 vjeçar i vlefshmërisë me Akt - miratimin Nr. 1488/1, datë 12.07.2021), për leje minerare shfrytëzimi, dorëzuar nga ana e subjektit "GJONI" sh.p.k. për mineralin gabro, që bën pjesë në grupin e mineraleve nderfimore, për objektin "Gjonbardhaj", Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:
 - a) Emri i subjektit: "GJONI" Sh.p.k.;
 - b) Numri unik i identifikimit (NUIS) J98220509 M
 - c) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes: z. Kole Toli.
 - d) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja: Gabro.
 - e) Adresa e selisë së subjektit: Lezhë, Ungrej, Lagjia Qender, Rruga e Përroit, Kariere gur dekorativ në zonën kadastrale nr. 1747, nr. Pasurie 1771 - I.
 - f) Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: Kole Toli
Nr. telefonit / faksit: Cel: 068 39 54 199
e-mail: tolikole67@gmail.com
 - g) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti: Njësia administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.
 - h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: Stakë Vukaj, ing. gjeolog, pajisur me leje profesionale, nr. 20, dt 28/01/2021.
 - k) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: pa afat.

2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 24, dhe kreun e IV të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, VKM Nr. 218, datë 11.03.2015, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe rregullave për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave për lejet minerare të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata", ndryshuar me VKM Nr. 52, datë 31.01.2018, Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 218, datë 11.03.2015, të Keshillit të Ministrave; "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe rregullave për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave për lejet minerare të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata", dhe i siguron të drejtën ekskluzive, subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit.

3. Afati ligjor i vlefshmërisë së lejes minerare të shfrytëzimit është afati i periudhës së mbetur të lejes minerare të shfrytëzimit Nr. 1488/1, datë 02.08.2010, sikurse është përcaktuar edhe në Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr. 28/2022, datë 30.08.2022.

4. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineraleve.

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë, Faqja web: <http://www.infrastruktura.gov.al>



2. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit e miratuar me vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot.MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është 572.121 lekë.

3. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit e miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt.01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është 71.515 lekë.

Kërkojmë nga ana Juaj, brenda afateve ligjore, nga data e publikimit të lejes tuaj të shfrytëzimit në Regjistrin Kombëtar të Licensave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të bëni derdhjen e këtyre garancive financiare në kodin si më poshtë vijon:

- Kodi në të cilin duhet të derdhen Garancitë Financiare për llogari të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është "4662103", i cili përfshin "Mjetet në Ruajtje".

Thëksojmë se, në rast mosparaqitje të dokumenteve të garancive financiare në QKB, brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimi për miratimin e lejes minerare vlerësohet automatikisht i revokuar.

Për më shumë informacion, drejtohuni në Web - në MIE, www.infrastruktura.gov.al, Sektori Minerar, Kuadri Ligjor (garancitë financiare).

Faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTRI

Belinda Balluku

Me Autorizim

ZEVENDËSMINISTRI

Ilir Bejtja



Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë, Faqja web: <http://www.infrastruktura.gov.al>

- Gabro, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.

5. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë;

KOORDINATAT		
PIKA	X	Y
1	46 44 175	43 99 550
2	46 44 350	43 99 710
3	46 44 325	43 99 870
4	46 44 393	43 99 870
5	46 44 310	44 00 130
6	46 44 350	44 00 200
7	46 44 293	44 00 227
8	46 44 190	43 99 880
9	46 44 275	43 99 800
10	46 44 100	43 99 640

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është 0.074 km².

Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e MIE dhe është pjesë e tij.


6. Përfutuesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për rastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.
7. Përfutuesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës.	Aktivitetet	Shpenzimet për programin e investimit
Viti me investim maksimal.	Studime projektive, rrugë, sheshe, sistemime.	500,000 lekë
Totali	Studime projektive, rrugë, sheshe, sistemime.	1,000,000 lekë
Periudha e Investimit	2 (dy) vite	

8. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit për realizimin e programit të investimit, (periudha e investimit është parashikuar të kryhet për 2(dy) vite, sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të përmbajë këto operacione pune :



Leja Minerare Nr.1488/2



1. Hapja e vendburimit (rrugë, transhe, sheshe depozitimi, ndërtim objekte të infrastrukturës)
me një vlerë totale prej 1,000,000 lekë dhe vlerë vjetore 500,000 lekë sipas përshkrimit në tabelën më sipër.

- Rezerva të nxjerrshme	20,000 m ³	me 50 % Olivinë
- Rezerva gjeologjike	68,730 m ³	me 50 % Olivinë
- Prodhim minerali në total	15,000 m ³	me 50 % Olivinë
- Prodhim minerali në vit	2,000 m ³	me 50 % Olivinë

- **Fuga punetore** për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të jetë **5 (pesë) punonjës**.

9. Vlera totale financiare për realizimin e programit të investimit e miratuar me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është **1,000,000 lekë**.
10. Vlera financiare për realizimin e programit të investimit per vitin maksimal e miratuar me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është **500,000 lekë**.
11. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit per vitin maksimal e miratuar me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është **50,000 lekë**.
12. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit miratuar me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr. 2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është **572,121 lekë**.
13. Vlera vjetore e garancisë financiare, për realizimin e planit të rehabilitimit,e miratuar me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr.2974/1, prot AKBN, datë 31.08.2022) është **71,515 lekë**.

14. **Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kondita specifike:**

1) Të njohë dhe të zbatojë rregulloren e teknikes se sigurimit per minierat dhe karrierat.

2) Të vlerësojë rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit dhe të mos shkaktojë dëmtime të tij. *(kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit; në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut mineral, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës, etj).*

3) Të kontrollojë vazhdimisht dhe të mirëmbajë në gjendjen teknike makineritë, sheshet e sigurisë në shkallë dhe ti kushtohet vemendje ruajtjes se kendit te projektuar per pjerrësinë e shpateve te shkalleve, si dhe rritjen e vemendjes ne ndarjen e shkalles ne nen shkalle per një efektivitet e kontroll me te mire te procesit te nxjerrjes.



4) Të sigurohet monitorimi i shëndetit të punonjësve në nënputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

5) Për kushtet gjeografike specifike në të cilën ndodhet objekti, subjekti duhet të vlerësojë sigurimin e mjeteve mbrojtëse individuale për punonjësit, sigurimin e paketes mjekësore të domosdoshme për ndihmën e parë në raste nevojë si dhe gjatë gjithë kohës duhet të mbajë në gadishmëri makine transporti në gjendje pune.

16. Përfutuesi i kësaj leje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi për detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

17. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me fax, pranë Qendrës Kombëtare të Biznësit ose :

MINISTER Zonja _____

- i. me postë: ADRESA: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë, Shqipëri
- ii. me fax: Nr. _____

ZOTËRUESI I LEJES SHFRYTËZIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SHFRYTËZIMIT Zotit: Kole Toli.

Shoqërisë: "GJONI" Sh.p.k ;

me postë: Lezhë, Ungrej, Lagjia Qender, Rruga e Përroit, Kariere gur dekorativ në zonën kadastrale nr.1747, nr.Pasurie.177/1-1.

ii. me fax: Cel: 068 39 54 199

E-mail: tolikole67@gmail.com.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


* Shënim:

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor maxhoritar kalimi i të drejtave të lejes minerare të shfrytëzimit, tek zotëruesi i ri i bëhet në përputhje me kërkesat e VKM nr.362, datë 29.04.2011 "Për miratimin e kritereve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare".

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, administratorin e shoqërisë, apo drejtuesin teknik, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të specifikojë emrat, adresat dhe interesin përkatës të personit apo entit përgjegjës për drejtimin e operacioneve në zonën e reja duke njoftuar 10 (dhjetë) ditë kalendarike më parë me shkrim Ministrin për realizimin e këtij ndryshimi.



Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë, Faqja web: <http://www.infrastruktura.gov.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MINERARE

Nr. 2776/Prot.

Tiranë, më 30.08/2022

Lënda: *Dërgohet Vendimi i Këshillit Teknik*

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORISË SË PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË
Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së, Nr.28/2022, datë 30.08.2022, për vlerësimin e dokumentacionit për zgjerimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1488/I, datë 02.08.2010, të paraqitur nga subjekti "GJONT" SHPK, me kërkesën Nr.LC-4379-06-2022, datë 30.06.2022, objekti "Gjonbardhaj", Ungrej, Bashkia Lezhë.

Ju falënderim për bashkëpunimin!

DREJTORI EKZEKUTIV

Adrian BYLYKU



Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri. Web: www.akbn.gov.al
Tel. +355 (0) 4 225 7117; Fax: +355 (0) 4 225 7362

Ky ndryshim duhet të dërgohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Ministri sipas ndryshimeve të reflektuara në ekstraktin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e shfrytëzimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje shfrytëzimi.

Ky akt - miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN për lejen minerare, vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, opionencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, Nr.28/2022, datë 30.08.2022 (nr.6516, prot MIE dt 01.09.2022 dhe Nr.2974/I, prot AKBN, datë 31.08.2022).


MINISTRI

Belinda Balluku

Me Autorizim

ZEVENDËSMINISTRI

Ilir Bejtja



Tiranë, më 13.10 2022